

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën e kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsionit, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Korrik, 2022

Nisin konsultimet teknike institucionale për koncept-dokumentin strategjik antikorrupsion, 2023-2030

14.07.2022. Ministria e Drejtësisë ka filluar fazën e konsultimit të draft koncept-dokumentit strategjik të antikorrupsionit, 2023-2030. Në një takim pune në format hibrid, të zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë, është prezantuar draft koncept - dokumenti strategjik antikorrupsion, 2023-2030. Strategjia e ardhshme e luftës kundër korrupsionit në nivel ndër-sektorial është e orientuar në tre shtylla kryesore, parandalim-ndëshkim-ndërgjegjësim, dhe për të cilën janë propozuar 17 objektiva specifike, që synojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në përputhje me objektivet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB, forcimin e integritetit publik kundër korrupsionit, promovimi i integritetit në sektorin privat, strukturimin e kornizës së sinjalizuesve kundër korrupsionit, rritjen e kapaciteteve (burime-struktura-performancë) për koordinimin kundër korrupsionit, transparencë në financimin e partive politike, lobizmi si instrument kundër korrupsionit, hetime administrative kundër korrupsionit, hetime penale me eficientë dhe efektive, bashkëpunim ndërkombëtar kundër korrupsionit, edukim dhe ndërgjegjësim kundër korrupsionit, forcimi i pjesëmarrjes së grave kundër korrupsionit. Aktualisht, është hartuar edhe pasaporta e indikatorëve e cila është konsultuar në takime të dedikuara pune me institucionet që janë identifikuar për të qenë pjesë e strategjisë kundër korrupsionit, 2023-2030, në javën e 25-29 korrik 2022.



Draft koncept dokumentin e strategjisë 2023-2030, mund ta gjeni të publikuar edhe në link:
<https://www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-kunder-korrupsionit/>

Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit finalizon draft raportin e monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, janar-mars 2022

Objektivi	Shtylla e rezultimit sipas masave
A.1 Rritja e transparencës në Verifikimet Shkretë dhe gjetjen e abuzit të sistemeve të informacionit	80 në 110 për qind e masave të zbatuara
A.2 Rritja e transparencës në planifikimin, monitorimin dhe kontrollin e fondave publike	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
A.3 Fungimi i informimit elektronik në institucione publike	80 në 110 për qind e masave të zbatuara
A.4 Promovimi i partive të denoncimit ndaj korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
A.5 Forcimi i rregullit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rritjen e konfidit të tyre	80 në 110 për qind e masave të zbatuara
A.6 Forcimi i rregullit të kontrollit të funksionit të partive politike	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
A.7 Promovimi i efikasitetit të analizës dhe interpretimit të brendshëm dhe jashtëm të detyrës së evidencimit të	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
A.8 Forcimi i integritetit të sektorit publik	80 në 110 për qind e masave të zbatuara
A.9 Forcimi i integritetit të sektorit publik	80 në 110 për qind e masave të zbatuara
A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, efikasitetit të masave antikorrupsion dhe përzierjes së statistikave në lidhje me raportimin e shqiptarëve ligjshëm kundër korrupsionit	80 në 110 për qind e masave të zbatuara
A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsionit në nivelin e shteteve vendore	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
B.1 Promovimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimit penal kundër korrupsionit	Në proces vlerësimi
B.2 Promovimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjshme në ndjekjen penale dhe administrimin penal të korrupsionit	Në proces vlerësimi
B.3 Rritja e kufijve ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	—
B.4 Promovimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë në përfaqësimet e korrupsionit	80 në 110 për qind e masave të zbatuara
C.2 Niveli i publikut për të përdorur aktivitetet mekanizimit për denoncimin e korrupsionit	80 në 110 për qind e masave të zbatuara
C.3 Integriteti i bashkëpunimit me shoqëritë civile	Në proces vlerësimi

19.07.2022. Ministria e Drejtësisë ka finalizuar raportin e monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, janar-mars 2022. Sekretariati Teknik pranë Ministrisë së Drejtësisë pas dakordësimit të përmbajtjes së raportit të monitorimit të zbatimit të veprimit antikorrupsion, për periudhën e parë të zbatimit të tij për vitin 2022, administron informacionin teknik të zhvillimit të angazhimeve antikorrupsion të 22 institucioneve publike. Raporti i monitorimit, jep një informacion të plotë dhe verësues mbi ecurinë e 18 objektivave specifike për të tre qasjet e politikave të parandalimit – ndëshkimit - ndërgjegjësimit kundër korrupsionit, mbështetur plotësisht në të dhënat e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara për zbatim. Në 3-mujorin e parë 2022, kanë qenë për zbatim 58 masa e 108 aktivitete, nga të cilat 34 masa/64 aktivitete janë realizuar plotësisht, 15 masa/11 aktivitete janë realizuar pjesërisht dhe 9 masa/3 aktivitete nuk janë realizuar. Niveli i zbatimit të Strategjisë Antikorrupsion për këtë periudhë është 78.25% dhe sipas qasjeve është: parandalimi - 86.50 %; ndëshkimi – 81.6 %; ndërgjegjësimi – 66.66 %. Sektorët që kanë shënuar progres në këtë periudhë janë transparencja e autoriteteve publike, digjitalizimi i shërbimeve elektronike, integriteti i nëpunësve publikë në ministrinë e linjës, ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me publikun kundër korrupsionit. Raporti final i monitorimit pritet të jetë pjesë



përbërëse e raportit 6-mujor të monitorimit të strategjisë antikorupsion, i cili ka filluar të hartohet në Ministrinë e Drejtësisë. Raporti pritet të përfundojë brenda muajit shtator 2022.

Raport i final i monitorimit, janar-mars 2022, mund të mund të aksesohen në linkun: <https://drejtesia.gov.al/viti-2022-2/>

Partnerët e luftës kundër korrupsionit nisin organizimin e edicionit të 4-t të “Javës së Integritetit” 2022

13.7.2022. Partnerët e aktivitetit ndërgjegjësues “Java e Integritetit” janë mbledhur dhe kanë zhvilluar takimin e parë para-përgatitor për zhvillimin e edicionit të 4-t të Javës së Integritetit 2022, që do të zhvillohet në 1-10 dhjetor 2022. Partnerët themelues të këtij aktiviteti gjithëpërfshirës dhe mobilizues në luftën kundër korrupsionit u mbledhën në takimin e parë organizuar nga ICC Albania për të dakordësuar vullnetin e përfshirjes në edicionin e radhës së kësaj nisme, dhe për të bashkërenduar propozimet e tyre dhe iniciativat që mund të ndërmerren në të. Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në vend, Ambasada e Hollandës në Tiranë, nga e cila është “huazuar” kjo iniciativë, Ambasada Britanike, Delegacioni i Komisionit Evropian, zyra e Këshillit të Evropës, prezenca e OSCE, zyra e koordinimit të projekteve të UNODC, institucioni i ILDKPKI, Ministria e Shtetit për Standardet e Sipërmarrjes diskutuan dhe dakordësuan vijueshmërinë e këtij aktiviteti. Java e Integritetit do të ketë në qendër të aktiviteteve qytetarin dhe rolin e tij aktiv në rritjen e integritetit. Një listë dhe planifikim me konkret për përfshirjen e institucioneve dhe organizatave në këtë nismë do të finalizohet në vijim.



Informacion të detajuar për këtë aktivitet mund ta gjeni të publikuar edhe në link: <https://www.facebook.com/ICCAAlbania>.



Takim rajonal në nivel politikash për Rikuperimin e Aseteve

7- 8.7.2022. Ministria e Drejtësisë, mori pjesë në takimin rajonal në nivel politikash për Rikuperimin e Aseteve, që u zhvillua në selinë e UNODC-së, në Vjenë, në datat 7-8 korrik 2022. Takimi rajonal u zhvillua në kuadër të projektit “Nga flukset e paligjshme financiare në rikuperimin e asetëve” pjesë e Programit Rajonal të UNODC për Evropën Juglindore. Programi synon të rrisë kapacitetet e vendeve si Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbisë dhe Kosovës për të rikuperuar të ardhurat dhe instrumentet e krimit dhe të forcojë shkëmbimin e informacionit ose provave që çojnë në sekuestrime dhe konfiskime në të gjithë juridiksionet e vendeve pjesëmarrëse. Projekti u fokusua gjithashtu në zhvillimin e udhërrëfyesve për rikuperimin e asetëve në nivel kombëtar dhe rajonal dhe ofrimin e mbështetjes në rritjen e asistencës së ndërsjellë ligjore për qëllimet e rikuperimit të asetëve. Shqipëria mori pjesë në këtë takim me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe SPAK. Në panelet e diskutimeve përgjatë dy ditëve, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë folën rreth bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dhe përpjekjeve ligjore e teknike të shtrira në nivel kombëtar për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në Shqipëri. Më tej, SPAK ndau disa nga historitë e hetimit proaktiv dhe rastet e sukseseve hetimore në konfiskimin dhe sekuestrimin e asetëve që burojnë nga veprimtaria e paligjshme.

Trajnim për forcimin e kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorupsion dhe Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit

5- 6.7.2022: Në datat 5 dhe 6 korrik 2022, Zyra e Këshillit të Europës në Tiranë organizoi një trajnim me temë “Auditimi i Brendshëm dhe hetimi administrativ i korrupsionit” në kuadër të objektivit specifik të AEC në Shqipëri “Përmirësimi i Kuadrit Ligjor dhe institucional për parandalimin e korrupsionit”. Ky trajnim synoi rritjen e kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorupsion, përkatësisht të stafit teknik me kompetenca investiguese dhe inspektuese si dhe Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, të emëruar në institucionet publike në nivel qendror e vendor. Bazuar në ekspertizën e ekspertëve të Këshillit të Europës, në këtë trajnim u prezantuan disa nga praktikat më të mira ndërkombëtare në kryerjen e auditimit të brendshëm dhe hetimeve administrative për parandalimin dhe ndëshkimin efektiv të korrupsionit. Trajnimi ofroi edhe disa trajtime praktike që lidhen me shembuj konkretë nga puna e përditshme e pjesëmarrësve, studimeve të rasteve në shqyrtim, analiza e riskut dhe bashkëpunimi me autoritetet e tjera publike.





Stafi i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion merr pjesë në kursin veror të IACA

1.7.2022. Akademia Ndërkombëtare Antikorrupsion (IACA), në Vjenë, Austri ka përfshirë në rrjetin e saj profesionistëve antikorrupsion për vitin 2022, anëtarë dhe staf të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë. Programi i Akademisë Verore Antikorrupsion pranë IACA është zhvilluar në periudhën 25 qershor – 1 korrik 2022, dhe është ndjekur intensivisht nga dy anëtarë-staf antikorrupsionit. Kurrikula e dedikuar për këtë Akademi Verore ishte e orientuar drejt njohjes dhe përdorimit të mekanizmave parandalues kundër korrupsionit, si: politikat e integritetit, mjetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit kundër korrupsionit, roli i medias investigative kundër korrupsionit, mjetet e komunikimit masiv dhe teknologjia e informacionit, mekanizmat e pastrimit të parave. Orientimi *gender* si një risi e shtuar dhe instrument antikorrupsion ishte pjesë e kurrikulës, gjithashtu. Akademia Verore Antikorrupsion u ndoq nga 55 pjesëmarrës nga 31 vende të botës.

Më shumë informacion mund të gjeni në këtë link: <https://www.iaca.int/>